

**ANA LALAJ**

**KONFERENCA E BUJANIT, 31 DHJETOR 1943 - 2 JANAR 1944,  
NJË ANALIZË E RIVLERËSUAR**

**(vijon nga nr. 1-2-2011)**

**Kosova midis dy lëvizjeve**

Rasti i Kosovës dëshmon qartë se gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, PKJ dhe PKSH ia kanë nënshtruar parimin e vetëvendosjes qëllimeve të tyre ideologjike dhe interesave klasore të kapjes së pushtetit. Të dy partitë komuniste e kanë shfrytëzuar parimin e vetëvendosjes nacionale më tepër si mjet propagandistik se sa si qëllim për t'u realizuar. Bashkëpunimi politik dhe ushtarak dhe miqësia e krijuar midis PKSH dhe PKJ gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, nuk ndihmuan që këto parti të merreshin vesh për zgjidhjen e problemit nacional të Kosovës në bazë të parimit të vetëvendosjes. Te komunistët serbë mungoi mirëkuptimi për të respektuar vullnetin e popullsisë së Kosovës në shumicë shqiptare. Në shtrimin dhe vendimmarrjet për çështjen e Kosovës predominuan emocionet, mendësitë dhe qëndrimet e skajshme si të forcave nacionaliste serbe ashtu dhe të udhëheqjes së PKJ. Internacionalizmi i saj rezultoi vetëm një slogan që nuk arriti të zhbëjë vendimet e Konferencës së Londrës (1913) apo të Versajës (1919) në Kosovë. Kosova mbeti një rast i pazgjidhur mes aspiratash e pretendimesh të papajtueshme, që la gjurmë negative në historinë e mëpasme të popullit të saj.

Partia Komuniste Shqiptare, e krijuar në vitet e vështira të luftës kundër pushtuesit, ishte partia më e re komuniste në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Nëse partitë e tjera komuniste evropiane u rigjallëruan pas sulmit të BS nga Gjermania naziste, për PKSH mund të themi se u krijua. Asaj i ra barra e rëndë të përballej dhe me çështjen e Kosovës. Megjithatë, në programin e PKSH, platforma konkrete për zgjidhjen e kësaj çështjeje mungoi. Kosova me një sipërfaqe më shumë se 1/3 e shtetit shqiptar të 1913-ës, me një popullsi në shumicë shqiptare, rreth 65-70%, me një histori heroike në lëvizjen kombëtare, dhe me një pasuri të lakmueshme mbitokësore dhe nëntokësore, konsiderohej një problem i pazgjidhur kombëtar për të gjithë shqiptarët kudo që ndodheshin. Lufta e

Dytë Botërore i ringjalli këto shpresa, si për ata që përjetuan bashkimin e Kosovës me Shqipërinë në gusht 1941, ashtu dhe për ata që besonin për një korrigjim legjitim të kufijve pas Luftës. Prandaj çështja e Kosovës u shfaq që në mbledhjen e themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare<sup>1</sup>, dhe vazhdoi më pas në Konferencën e Pezës<sup>2</sup>, në Konferencën e Mukjes<sup>3</sup>, në Konferencën e Labinotit<sup>4</sup>, e në një varg takimesh e letërkëmbimesh midis

<sup>1</sup> *AQSH*, Fondi (më tej: F.) 14/AP-PKSH, viti (më tej: V.) 1942, dosja (më tej: D.) 5, f. 2. Në mbledhjen themeluese të PKSH, në nëntor 1941, megjithëse problemi i Kosovës u ngrit nga Koço Tashko, Mustafa Gjinishi dhe Anastas Lulo, nuk u mor asnjë vendim për Kosovën, pasi i deleguari i KQ të PKJ, Miladin Popoviç, e trajtoi çështjen e Kosovës si problem, i cili i takonte vetëm PKJ. Në letërën që Koço Tashko kishte përgatitur për Kominternin shkruhet se që në fillim qëndrimi i Miladin Popoviçit kishte qënë: “Kjo është puna e PKJ dhe neve s’kemi pse të ngatërrohemi dhe s’mund të lejohet që të ngatërrohemi”. Shih gjithashtu: Kristo Frashëri, *Historia e sërë majtës në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878-1941*, Tiranë: “Ilar”, 2006, f. 254-262.

<sup>2</sup> *Dokumenta të Organeve të Larta të Pushtetit Revolucionar Nacional Çlirimtar (1942-1944)*, Tiranë: 1962, f. 14. Në Rezolutën e Këshillit NÇ që u formua në Konferencën e Pezës, u caktua si objektivi lufta për një “Shqipëri të lirë, të pandashme, independente dhe demokratike”. Termi “e pandashme” që nënkuptonte një Shqipëri ku të përfshihej Kosova dhe viset shqiptare të ndara padrejtësisht nga trangu etnik, asnjëherë nuk u shpjegua qartë në popull. Ndërsa një vit më vonë, më 10 korrik 1943, në Proklamatën e Këshillit të Përgjithshëm NÇ dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ, drejtuar popullit shqiptar, përcaktimi “e pandashme” ishte hequr. Thirrja bënte fjalë vetëm për “Shqipërinë e lirë, independente dhe demokratike”. (Po aty, f. 33).

<sup>3</sup> *AQSH*, F. 14/AP-PKSH, V. 1943, D. 21, f. 9. Në Konferencën e Mukjes të mbledhur më 1-2 gusht 1943, u organizua një takim i përbashkët i delegatëve të Frontit NÇ dhe delegatëve të Ballit Kombëtar. Aty u mor vendim për krijimin e një komiteti të përbashkët luftar: “Komiteti i Shpëtimit të Shqipërisë” me 6 përfaqësues nga secila palë; për luftë imediate kundër armikut okupator; për luftë për një Shqipëri independente; për një Shqipëri ethike, në zbatim të parimit të vetëvendosjes së popujve; për një Shqipëri të lirë, demokratike, popullore etj. Në fund të mbledhjes doli një thirrje drejtuar popullit shqiptar, ku bëheshin të njohura vendimet e Konferencës së Mukjes.

<sup>4</sup> *Dokumenta të Organeve të Larta...*, f. 50. Në Rezolucionin e Konferencës së Dytë Nacional Çlirimtare, mbajtur në Labinot, më 8 shtator 1943, u dënua Marrëveshja e Mukjes midis delegacionit të Ballit Kombëtar dhe delegacionit të Këshillit NÇ. Aty thuhet se “Lëvizja NÇ e ka për detyrë ta bëjë popullin e Kosovës të ndërgjegjshëm për aspiratat e tija, duke i thënë se ka për të shpëtuar vetë, me luftë, nga okupatori fashist ose nga okupatori eventual jugosllav, si Mihajlloviçi”.

udhëheqësve komunistë shqiptarë e jugosllavë, por asnjëherë nuk u arrit një konsensus për zgjidhje konkrete dhe të qëndrueshme. Për më tepër, sa më shumë lufta i afrohej suksesit, aq më i ndërlikuar paraqitej problemi i Kosovës e aq më larg shtyhej zgjidhja e saj. Në kushtet kur PKSHE sapo ishte formuar, kur në rreshtimin e saj ideologjik e vetmja lidhje me Kominternin dhe BS bëhej nëpërmjet PKJ, kur në vendimmarrjet e saj për Kosovën dhe për çdo problem tjetër politik dhe ushtarak ndikonin dukshëm emisarët e PKJ pranë saj, vija e PKSHE për Kosovën, herë hapur e herë heshturazi, u identifikua me atë të PKJ. Është me rëndësi të përmendim se në këtë shkarje të PKSHE ndikoi së tepërmi edhe ndarja e madhe që ndodhi midis saj dhe forcave nacionaliste shqiptare, të cilat nuk u pranuan të merrnin pjesë në Frontin NÇ Antifashist, me organizatat e tyre të mëvetësishme politike, por vetëm si individë. Nacionalistët, pjesëmarrës në Front apo jashtë tij, e ngrinin vazhdimisht dhe parashtronin zgjidhje konkrete për çështjen e Kosovës, gjë që trazonte ndjenjat kombëtare të shqiptarëve dhe krijonte tollovi në radhët e komunistëve shqiptarë. Ishte kjo arsyeja që emisarët jugosllavë në PKSHE, zëdhënës të interesave të PKJ, u treguan të vendosur për të mos lejuar që nacionalistët shqiptarë të bëheshin pjesë në zgjidhjen e problemit të Kosovës<sup>5</sup>.

PKSHE, e krijuar pas fillimit të rezistencës antifashiste në Shqipëri dhe në Jugosllavi dhe me emisarët jugosllavë mbi kokë, u pajtua me faktin që PKJ të udhëheqë Luftën Nacionalçlirimtare në Kosovë. PKJ ishte anëtare e Kominternit dhe në rreshtimin ku bënte pjesë PKSHE e sapokrijuar, një

---

<sup>5</sup> Vladimir Dedijer, *Marrëdhënjet jugosllavo-shqiptare (1939-1948)*, Beograd: "Prosveta", 1949, f. 93-97, 112.

Shih gjithashtu: Elisabeth Barker, *British Policy in South -East Europe in the Second World War*, Great Britain: "Harper & Row Publishers, INC, Barners & Noble Import Division"1976, f. 177. Sipas Barker: "Megjithëse britanikët nuk e dinin, në atë kohë përfaqësuesi jugosllav partizan, Vukmanoviç Tempo [Vukmanović Tempo], të cilin Tito e kishte udhëzuar të kontaktonte me komunistët shqiptarë dhe grekë, vizitoi Shqipërinë në korrik 1943 dhe në kohën kur Enver Hoxha po planifikonte të zhvillonte bisedime me udhëheqësit e Ballit Kombëtar, i rekomandoi atij që linja korrekte ishte thyerja me Ballin Kombëtar, duke përfutur ushtarët e thjeshtë në LNÇ dhe duke denoncuar ata drejtues të Ballit Kombëtar, të cilët bashkëpunonin me pushtuesit. Hoxha u nënshtrua dhe këshilla e Vukmanoviç Tempos u pranua dhe qëndrimi i LNÇ ndaj Ballit Kombëtar u ashpërsua. Ndërhyrja e Vukmanoviç Tempos do të thoshte që shpresat britanike për ruajtjen e unitetit të shqiptarëve ishin shkatëruar.

hap i tillë ishte normal. Gjithashtu kishte dhe një rast analog, kur PK Bullgare, me urdhër të Kominternit, u detyrua të heqë dorë nga bashkimi me Komitetin Rajonal të Maqedonisë i realizuar në fillim të Luftës, dhe ky i fundit të kthehej në kuadrin e PKJ, ku bënte pjesë para Luftës. Kjo vijë e Kominternit, që linte të paprekur autoritetin e çdo partie komuniste brenda kufijve territorialë të shtetit ku ajo vepronte para Luftës, u respektua nga PK Bullgare, PK Hungareze, PK Greke dhe PKS (pas krijimit në nëntor 1941). Në rrjedhë të këtij procesi, udhëheqja e PKS u “dërgoi një letër qarkore anëtarëve të Partisë të cilët kishin ardhur nga Shqipëria e Vjetër\* në Kosmet, me anën e së cilës u bënte thirrje që të qëndrojnë nën udhëheqjen e Komitetit Qarkor për Kosmet”<sup>6</sup>. Në kushtet e atëhershme, komunistët shqiptarë me origjinë kosovare, të ardhur nga Shqipëria, ishin e vetmja shpresë për ngritjen e kosovarëve në luftë<sup>7</sup>.

Në kushtet e bashkëpunimit të ngushtë midis dy partive komuniste, PKS dhe PKJ, presupozohej që të dyja palët të zhvillonin që në fillim

<sup>6</sup> *Zbornik dokumenata i podataka o Narodnooslobodilačkom ratu Jugoslovenskih naroda*, Tom II, Knjiga 10, *Dokumenta Vrhovnog Štaba Narodnooslobodilačke vojske Jugoslavije, 1943*, Beograd: 1962, dok. 65, f. 154. Letër e Z.V.Tempos dërguar KQ PKJ më 8 gusht 1943.

Shih gjithashtu: Spasoje Gjakoviç, “Communist Party of Yugoslavia in the National Liberation Struggle and the Revolution in Kosovo and Metohija”, në librin *Kosovo, Past, and Present*, Belgrade: 1989, f.123. Spasoje Gjakoviç përmend në artikullin e tij edhe një pohim të Pavle Joviçeviçit, sekretarit të KK të Kosovës: “Udhëheqja e PKS në miratimin e saj dërguar komunistëve të ardhur nga Shqipëria e Vjetër në Kosovë thoshte: “Pranoni antarësinë në PKJ, por ju do të vazhdoni të jeni anëtarë të PK të Shqipërisë”, f. 123-138.

\* “Shqipëria e Vjetër” quhej Shqipëria me kufijtë e caktuar nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. kurse “Shqipëria e Re” ose “Tokat e Lirume” quheshin Kosova, Rrafshi i Dukagjinit, Dibra, Kërçova, Tetova, pra të gjithë territoret shqiptare që i ishin bashkëngjitur Shqipërisë së paraluftës nga pushtuesit italianë në gusht 1941.

<sup>7</sup> *AQSH*, F. 14/AP-PKS, V. 1943, D. 39. Në një letër që Fadil Hoxha, komandant i Shtabit Ushtarak të Kosovës e Metohisë, i dërgon KQ të PKS më 7 shtator 1943, shkruan: “Po ju theksoj dhe njëherë se kemi mungesë kuadrosh shqiptare p.sh. në Prishtinë nuk kemi asnjë anëtar partie shqiptar, si dhe asnjë të ri komunist shqiptar. Po kështu qëndron puna dhe në shumë organizata të tjera të Kosmetit. Prandaj duhet të bani çmos që të na dërgoni shokë si legalë ashtu edhe ilegalë, se ma kosovarët po se po. Hajdar Dushin, Sejdin Avdiçin, Xhafer Vokshin, Mark Ulin etj. na i nisni sa më parë po deshët me na pa pak mirë. Kini kujdes me na çue shokë legalë”.

një diskutim të hapur dhe të ndershëm për çështjen e Kosovës. Por kjo nuk u bë. Në vitin e dytë të Luftës, Tito shkroi në revistën *Proleter* se “Partia Komuniste Jugosllave nuk ka për t’i braktisur kurrë parimet e veta të cilat kanë qenë vendosur nga mësuesit dhe udhëheqësit tanë të mëdhenj, Lenin, Stalin, parimin që çdo popull ka të drejtë për vetëvendosje deri në shkëputje. Çështja e Maqedonisë, çështja e Kosovës dhe e Metohisë, çështja e Malit të Zi, çështja e Kroacisë, çështja e Sllovenisë, çështja e Bosnjës dhe Hercegovinës, ka me u zgjidhë lehtë e përgjithësisht kënaqshëm për të gjithë, vetëm në mënyrën kur atë ta zgjidhë vetë populli, por secili popull e fiton këtë të drejtë me pushkë në dorë, në luftën e sotme nacionalçlirimtare”<sup>8</sup>. Sigurisht kjo deklaratë ishte mjaft fisnike dhe Tito ia lejoi vetes ta bëjë kur lufta sapo kishte filluar dhe PKJ ishte akoma larg pushtetit. Sidoqoftë, në plan propagandistik, kjo deklaratë ishte një referencë e fuqishme dhe tunduese.

Por në terren komunistët jugosllavë vepronin ndryshe. Emisari i Titos në Tiranë, Miladin Popoviç, u mbyllte gojën komunistëve shqiptarë duke u thënë se: “Çështja e Kosovës nuk na përket neve por i përket PKJ” ose “Kominterni ka vendosur që çështja e Kosovës është një çështje që do të zgjidhet vetëm prej Jugosllavisë demokratike dhe Shqipërisë demokratike”<sup>9</sup>. Në këto rrethana ku realiteti kundërshtonte propagandën, ku mungonin veprimet konkrete të PKJ që të jepnin siguri dhe garanci se çështja e Kosovës ishte vënë në rrugën e zgjidhjes, PKSHP mbetej gjithmonë një hap prapa, jo vetëm në varësi të vendimeve të të Mëdhenjve por edhe të vendimeve të udhëheqjes jugosllave. Në vijim, PKSHP ia la problemin e Kosovës politikave të ditës dhe parimi i vetëvendosjes pothuajse u shndërrua në një slogan pa përmbajtje.

Enver Hoxha heshtjen e PKSHP për problemin e Kosovës e arsyeton kështu në një letër sekrete që i dërgon Stalinit në gusht 1949: “Ne kemi menduar se çështjen e Kosovës nuk mundej ta vinim në diskutim *gjatë Luftës Nacionalçlirimtare*. Jugosllavia në Luftën Nacionalçlirimtare ishte aleatja e popullit tonë dhe nuk mund të binim në pozitat e reaksionit

<sup>8</sup> Josip Broz Tito, *Sabrana Djela, tom 13*, “Nacionalne pitanje u Jugoslaviji u svetlosti Narodnooslobodilačke borbe” (Çështja nacionale në Jugosllavi në dritën e Luftës Nacionalçlirimtare), Beograd: 1982, f. 95.

<sup>9</sup> *AQSH, F 14/AP-PKSH, V. 1942, D. 5, f. 1-9*. Shih letrën e Koço Tashkos dhe letrën e Miladin Popoviçit përgatitur për t’ia dërguar Kominternit.

shqiptar”<sup>10</sup>. Natyrshëm lind pyetja: Mbi ç’bazë mbështetej aleanca ndërmjet PKSH dhe PKJ? A ishte e sinqertë kjo aleancë kur mënjanoreshin çështje kaq të rëndësishme kombëtare për shqiptarët?

Përgjigja mund të gjendet në vetë pohimet e Hoxhës në po këtë letër: “*Në pragun e çlirimit të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, përsëri ne kemi menduar se nuk mundej ta shtronim çështjen e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, pse ishim përpara detyrave të forcimit e të konsolidimit të pushteteve tona demokratike popullore... Ne kemi menduar se te Jugosllavia Demokratike Popullore dhe te PKJ kishim një aleate besnike, të fortë dhe në interesin e kampit të socializmit dhe veçanërisht në interesin e Shqipërisë. Duhej të evitonim situata të vështira, që mund të krijoheshin në Jugosllavi, meqenëse dhe atje ishte duke u mëkëmbur e duke u forcuar regjimi demokratik popullor*”<sup>11</sup>. Pra kapja e pushtetit në Shqipëri, ashtu si në Jugosllavi, ishte çështje madhore e politikës së PKSH në fund të luftës. Gjithnjë nën këtë optikë mund të shpjegohet edhe përkujdesja vetëmohuese ndaj PKJ. Nëse Jugosllavia Federative Demokratike dhe PKJ ishin aleatë besnikë të Shqipërisë, siç shprehet Hoxha, a nuk duhej që edhe ato të shqetësoheshin për Kosovën dhe fatin e saj?

Duke ndjekur arsyetimet e Enver Hoxhës, njeriu e ka të vështirë të dallojë se ku mbaron dhimbja e ku fillon hipokrizia e tij për Kosovën. “*Në kohët e para të çlirimit, shkruan ai, demokracia popullore e Shqipërisë së vogël ishte një shenjë e lehtë për goditje nga ana e imperializmit dhe në rast sulmi të Shqipërisë nga imperializmi, formohej një humbje më e madhe për çështjen e përbashkët. Kosova ishte më pak në rrezik duke qëndruar në kohët e para e bashkuar me Jugosllavinë*”<sup>12</sup>. Pra, pas Luftës, shqetësimi i Hoxhës ishte më i madh për Kosovën se sa për Shqipërinë?! Akoma më tej, Kosova iu la Jugosllavisë, ku ajo do të ishte e siguruar!? Por a nuk do të ishte më e siguruar Kosova po të bashkohej me shtetin amë, dhe a nuk do të ishte më e fuqishme Shqipëria nëse bashkohej me Kosovën në këtë moment? Sigurisht, shpjegimet dhe justifikimet e Enver Hoxhës nuk janë as të sinqerta dhe as të besueshme.

<sup>10</sup> *Po aty*, F. 14, Marrëdhëniet me PK (b) BRSS, V. 1949, D 1. Letra e Enver Hoxhës dërguar Stalinit në gusht 1949.

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> *Po aty*.

Në të vërtetë mungesa e strategjisë së udhëheqjes shqiptare për çështjen e Kosovës në vitet e para të Luftës, kishte krijuar konfuzion te komunistët shqiptarë. Në një letër të përgatitur për t'ia dërguar Kominternit në vitin 1942, Koço Tashko, një nga komunistët më të vjetër shqiptarë, shkruante: “Anëtarët e partisë në propagandën e tyre vijnë vërdallë në një errësirë të plotë në lidhje me këtë çështje dhe nuk kanë mundur t'i përgjigjen shtypit fashist... Ndërsa nacionalistët kërkojnë shpjegime prej nesh, por ne nuk mund t'u themi atyre asgjë konkretisht”<sup>13</sup>.

Heshtja e PKSHE për problemin e Kosovës u bë e thellë sidomos pas Mbledhjes së Mukjes dhe Konferencës së Dytë të Këshillit NÇ në Labinot. Shprehja se “Ngritja e problemit të Kosovës çon ujë në mullirin e okupatorit” u bë slogan i ditës. Duke kritikuar vendimet e Mukjes për “Shqipëri etnike”, Enver Hoxha thekson në Konferencën e Labinotit: “Populli shqiptar që ka vuajtur nuk do të skllavërojë e të copëtojë tjetrin që ka vuajtur si ai kësaj reciprokisht... Çështja e Kosovës dhe e Çamërisë do të zgjidhet në bazë të Kartës së Atlantikut; në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve”<sup>14</sup>. Kjo gjuhë refuzuese e udhëheqësit shqiptar, që fshihej pas parimeve, në të vërtetë e kthente problemin e Kosovës pas disa vjet lufte, në pikën e nisjes, madje edhe më keq. Sigurisht problemet etnike janë të vështira për t'u zgjidhur se i kanë rrënjët thellë në histori prej nga zë fill një kujtesë e hidhur konfliktesh territorialë. Dihej që shqiptarët ishin një popull i ndarë dhe se ishte e drejtë e tyre natyrore që të bashkoheshin. Nëse midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës vihej shenja e barazimit, si të copëtuar e të vuajtur reciprokisht, kjo e çvendoste zgjidhjen e problemit të Kosovës nga axhenda politike e kohës. Në Shqipëri, ashtu si në shumë vende të pushtuara, po ndjehej era e pushtetit dhe nëpërmjet këtij internacionalizmi deklarativ, Hoxha synonte të siguronte mbështetjen jugosllave, jo për Kosovën por për pushtetin e tij.

PKJ dhe PKSHE në të rrallë zhvillonin një propagandë të përgjithshme për vetëvendosjen. Aq më pak ndërmerreshin në praktikë hapa konkretë për t'i premtuar kosovarëve se fati i tyre do të vendoset nga vetë ata pas luftës, nëpërmjet zgjedhjeve të lira ose me plebishit dhe vetë ata do të

<sup>13</sup> *Po aty*, F. 14/AP-PKSH, V. 1942, D. 3. Shih letrën e Koço Tashkos përgatitur për t'ia dërguar Kominternit.

<sup>14</sup> *Dokumenta të Organeve të Larta ...*, f. 50-51.

vendosin se në cilin shtet duan të jetojnë. Këtë heshtje e thyenin vetëm nacionalistët shqiptarë, të cilët shtronin hapur alternativën e bashkimit si zgjidhje të problemit të Kosovës<sup>15</sup>. Fjala e tyre vinte përpara detyrimit udhëheqësit e PKSH, por dhe këshilltarët jugosllavë pranë saj. Këta të fundit, aq sa kishin mundur i kishin zbrapsur komunistët shqiptarë nga diskutimet dhe hartimi i një platforme konkrete për Kosovën<sup>16</sup>. Megjithatë kjo nuk mund të vazhdonte pafundësisht. Kosova ishte një dimension i çështjes kombëtare shqiptare që nuk mund të shmangej. Delegatët jugosllavë, Popoviç, Mugosha, Tempo, bashkë me udhëheqësit më të lartë të PKSH, diskutonin midis tyre për Kosovën, por në kushtet kur PKJ nuk kishte platformë konkrete<sup>17</sup> për këtë çështje, ata mbeteshin konfuzë dhe të varur. Enver Hoxha nuk pati kurajon t'i shkruajë Titos për problemin e Kosovës. Në letërkëmbimin Tito-Enver gjatë viteve të Luftës, vihen re vetëm lavde dhe falënderime për Jugosllavinë, për PKJ dhe për vetë Titon. Por kur në mesin e vitit 1943, Balli Kombëtar dhe PKSH hodhën disa hapa konkretë për bashkëpunim dhe në mbledhjen e organizuar midis përfaqësuesve të këtyre dy organizatave politike, më 26 korrik, në fshatin Tapizë, nacionalistët shqiptarë ngritën me forcë

<sup>15</sup> Spasoje Gjakoviç (Spasoje Đaković), *Sukobi u Kosovu*, Beograd: "Narodna Knjiga", 1984, f. 401. Dokument i bashkëngjitur librit: Letra e Miladin Popoviçit dërguar Ivan Milutinoviçit më 29 korrik 1943. Në këtë letër Miladin Popoviç shkruan: "Kjo çështje [e Kosovës] nuk do të dukej aq e vështirë sikur atë të mos e ngrinte dhe për të të mos interesohej një pjesë e zotërinjve "liberalë" shqiptarë dhe një pjesë e patriotëve shqiptarë që tashmë marrin pjesë në Luftë (në radhët e Këshillit Nacional Çlirimtar). Borgjezia e shtron këtë çështje në mënyrë të caktuar".

<sup>16</sup> *AQSH*, F 14/AP-PKSH, V. 1942, D. 5, f. 1-20. Shih letrën e Koço Tashkos dhe letrën e Miladin Popoviçit përgatitur për t'ia dërguar Kominternit. Në këto dy letra shihet se M. Popoviçi ka qëndrime të ndryshme për zgjidhjen e çështjes së Kosovës: "Fashizmi solli të ashtuquajturën Evropë të re dhe Shqipëria e re. Po ç'ti bësh se komunistët nuk e kanë njohur këtë ndryshim dhe për ta gjithçka ka mbetur në atë të vjetrën"; "Çështja e Kosovës nuk na përket neve por i përket PKJ"; "Kominterni ka vendosur që çështja e Kosovës është një çështje që do të zgjidhet vetëm prej Jugosllavisë demokratike dhe Shqipërisë demokratike"; "Për Kosovën është mirë të rrijë nën PKJ se Jugosllavia ka për t'u çliruar më parë se Shqipëria".

<sup>17</sup> S. Gjakoviç, *Sukobi u Kosovu...*, f. 401. Dokument i bashkëngjitur librit: Letër e Miladin Popoviçit dërguar Ivan Milutinoviçit më 29 korrik 1943. Në këtë letër Miladin Popoviçi shkruan: "Komiteti tonë Qendror shtron çështjen e Maqedonisë, të Sllovenisë (nën okupacionin italian), të pakicave nacionale gjermane etj. ,ndërsa për Kosovën nuk flitet".

çështjen Kosovës, shqetësimi i udhëheqësve të PKSH dhe i emisarëve jugosllavë u rrit. Pikërisht në këtë kohë, më 29 korrik, Miladin Popoviçi i shkruan Ivan Milutinoviçit<sup>18</sup>: “Lidhur me çështjen e Kosovës dhe Metohisë duhet të ndryshojë qëndrimi i deritanishëm edhe nga partia shqiptare [PKSH] edhe nga partia jonë [PKJ]. Duhet të gjendet një zgjidhje që të mund të plotësojë kërkesat në tërësi për çështjen e Kosovës e të Metohisë. Përndryshe do të ishte e vështirë që vetëm me anën e një trakti të kënaqen organizatat në të cilat paraqitet edhe çështja e propocionalitetit në forume... Jam i mendimit se do të mund të mbahej qëndrim [për Kosovën] ashtu si ai për çështjen e Istrias e Sllovenisë”<sup>19</sup>.

Ka edhe një letër të Tempos dërguar KQ të PKJ për të njëjtin problem, disa ditë më vonë, më 8 gusht 1943. Në të shprehen propozimet e drejtuesve të PKSH dhe të Miladin Popoviçit për një varg masash të përkohshme që do të ndikojnë në zhvillimin e Luftës kundër pushtuesit në Kosovë. Tempo shkruante: “KQ i PKSH dhe Miladini [Popoviç] propozojnë që masat shqiptare të vihen nën komandën e një shtabi shqiptar në Kosmet, i cili do të ishte nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm të Shqipërisë, ndërsa ato serbe nën komandën e Shtabit tonë [Shtabi i Përgjithshëm i UNÇJ]. Milo [pseudonimi i Miladin Popoviçit gjatë Luftës] madje mendon që është e nevojshme që Metohija<sup>20</sup> në pikëpamje organizative partie të hyjë në përbërje të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Unë mendoj që këto masa me të vërtetë do ta lehtësonin grumbullimin e masave shqiptare në LNC, por nga ana tjetër ne do të humbim shumë te populli serb. Prandaj për këtë çështje unë nuk mund të jap asnjë zgjidhje derisa t’ju pyesja juve për këshillë”<sup>21</sup>.

Përgjigja e Milutinoviçit për propozimin e Miladinit ishte brenda kornizave propagandistike. Veçse këtë herë slogani “vetëvendosje”, përdorur në raste të ngjashme, mungonte. “Nuk duhet të mbani qëndrim, shkruante Milutinoviçi, sikurse qëndrimi i borgjezisë reaksionare

<sup>18</sup> Ivan Milutinoviçi ishte anëtar i Byrosë Politike të PKJ dhe i deleguar i Shtabit të Përgjithshëm NÇ të Jugosllavisë dhe KQ të PKJ, në Mal të Zi.

<sup>19</sup> S. Gjakoviç, *Sukobi u Kosovë...*, f. 402-403. Dokument i bashkëngjitur librit: Letër e Miladin Popoviçit dërguar Ivan Milutinoviçit, më 29 korrik 1943.

<sup>20</sup> Në vitin 1943, Komiteti Krahinor i PKJ për Kosmetin ishte i ndarë në dy komitete vartëse: Komitetin Qarkor të Kosovës dhe Komitetin Qarkor të Metohisë, rajon ku popullsia shqiptare ishte pothuajse homogjene.

<sup>21</sup> *Zbornik ...*, Tom II, Knjiga 10, dok. 65. f. 154. Letër e Vukmanoviç Tempos dërguar KQ PKJ më 8 gusht 1943.

shqiptare, domethënë që kjo pjesë të bashkohet që tani me Shqipërinë. Por me rrugën e luftës së përbashkët duhet t'i çlirojmë këto vise nga okupatori dhe të gjithë tradhëtarët e vendit, kurse më vonë popujt do të shprehen se çfarë duan dhe ku duan të venë<sup>22</sup>.

Ndërsa përgjigja e Titos, më 6 dhjetor 1943, ishte sa demagogjike aq edhe fshikulluese. Tito, përgjigjen e tij ia drejton jo Popoviçit, i cili kishte firmosur letrën e 29 korrikut, por Komitetit Qendror të PKSH. Në fund të fundit, janë drejtuesit shqiptarë ata që do të merrnin përgjegjësitë e do të vepronin. Në letrën e tij, Tito shkruante: “Shoku Milo nuk ka të drejtë kur thotë se partia jonë dhe ajo e Shqipërisë, do të duhesh të paraqisnin qëndrimin e tyre ndaj çështjes së Kosovës dhe Metohisë dhe kur Kosovën dhe Metohinë e krahason me Istrën e Slloveninë... Të shtrohet sot çështja e bashkimit, kjo në të vërtetë do të thotë të çosh ujë në mullirin e reaksionarëve të ndryshëm dhe vetë okupatorit, të cilët duan të pengojnë luftën e armatosur të popullit<sup>23</sup>. Në të njëjtën ditë dhe me të njëjtën “gjuhë”, Tito i shkruante edhe Tempos: “Parulla për bashkimin e Kosovës dhe Metohisë me Shqipërinë sot, të cilën e propozon Miladini [Popoviç], si dhe qëndrimi që Metohija të vihet nën komandën e Shtabit Suprem Shqiptar, në fakt do t'i shkonte për shtat të gjithë armiqve të Luftës NÇ në Jugosllavi dhe gjithë klikave reaksionare dhe fashiste, të cilat kanë për synim që nga lëvizjet demokratike të popujve të Jugosllavisë të shkëpusin copë-copë dhe në plan të parë të nxjerrin jo çështjen e luftës kundër okupatorit, por nxitjen e kundërthënieve nacionale etj.”<sup>24</sup>. Ka arsye që Tito nuk pranon të mbajë një qëndrim konkret ndaj problemit të Kosovës, arsye të cilën ai e mban të fshehur. Katër ditë më parë, më 29 nëntor 1943, Konferenca e Dytë e AVNOJ-t e

<sup>22</sup> S. Gjakoviç, *Sukobi u Kosovu...*, f. 395. dokument: Letër e Ivan Milutinoviçit dërguar KQ PKSH më 25 tetor 1943; Shih gjithashtu: Izber Hoti, *Të dhëna të panjohura për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë*, Prishtinë: 1999, f. 30.

<sup>23</sup> *AQSH*, F. 14/AP-PKSH, V. 1943-1944, D. 39. Letra e J.B.Titos dërguar KQ të PKSH më 6 dhjetor 1943. Kjo letër që gjendet në arkivat shqiptare mban datën 6 dhjetor. Kurse në burimet jugosllave mban datën 2 dhjetor 1943 (Josip Broz Tito, *Sabrana Djela, Tom Osamnaest*, Beograd: 1984, f. 5); Shih gjithashtu: Agim Zogaj, *Ndërrhyrja e PKJ-së në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore*, “Zeri”, Prishtinë, 2003, f. 81.

<sup>24</sup> J. B. Tito, *Sabrana Djela, Tom Osamnaest...*, f. 19. Për më shumë shih gjithashtu: Gëzim Ostreni, *Shpresa dhe zhgënjimi i shqiptarëve në Maqedoni gjatë dhe pas Luftës Dytë Botërore*, Prishtinë: “Dukagjini”, f.66-69.

kishte vendosur që Kosova të mbetej në kuadër të federatës jugosllave. Ai nuk është më i shqetësuar përse shqiptarët e Kosovës janë të ftohtë dhe hezitues për të marrë pjesë masivisht në luftë. Kjo alternativë tanimë ishte tejkaluar. Madje, Tito në këto momente “mund të ishte i interesuar që të mos kishte kurfarë rezistence në Kosovë”<sup>25</sup>, me qëllim që shqiptarëve t’u mbyllej goja në fund të Luftës. Shqetësimi i tij ishte për të implementuar vendimet e AVNOJ-t, të cilat kënaqnin nacionalistët e komunistët jugosllavë, duke dhunuar parimin e vetëvendosjes që ai vetë kishte deklaruar. As Tito dhe as bashkëpunëtorët e tij nuk i përgatitën shqiptarët dhe popujt e Jugosllavisë për një zgjidhje demokratike e parimore të problemit të Kosovës. Karta e Atlantikut presupozonte bashkëpunim dhe shpresë, por Tito e shfrytëzoi atë për aq sa pati nevojë. Në fillim të Luftës ai bëri premtime për vetëvendosjen, kurse në nëntor 1943, në mbledhjen e Jajcës, kur fitorja mbi Boshtin dukej e sigurt, Tito ngriti pushtetin revolucionar, i ndaloi Mbretit Pavle Karagjorgjeviç (Pavel Karađorđević) kthimin në Jugosllavi dhe shpalli federatën, veprime këto që ishin në kundërshtim me vendimet e të Mëdhënjeve të Aleancës në vitet e Luftës<sup>26</sup>. Tito e parashikonte rebelimin e shqiptarëve të Kosovës kur ata do të ndodheshin përpara faktit të kryer, por për të, më mirë të kishte kundër Prishtinën se sa Beogradin. Kështu mendonte Tempo, kështu mendonin dhe udhëheqësit e tjerë jugosllavë. Vite më vonë Bakariçi e ka shpjeguar këtë qëndrim të udhëheqjes jugosllave ndaj Kosovës: “Në qoftë se ne do të arrinim në vendimin për Kosovën, në bazë të parimit abstrakt të së drejtës së vetëvendosjes deri në shkëputje, kjo do të dobësonte shumë luftën tonë në Serbi dhe do t’i jepte një argument jashtëzakonisht të fuqishëm borgjezisë serbe dhe Drazha Mihajloviçit. Ata do të na akuzonin ne se, po e copëtonim Jugosllavinë. Në këtë kohë ne nuk e kishim marrë as Serbinë dhe pa Serbinë nuk do të kishim as Jugosllavinë...”<sup>27</sup> Pra, Kosova ishte vendosur në një fushë ku luanin lojtarë serbë e jugosllavë, por jo shqiptarë.

<sup>25</sup> Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: SHB Lidhja e Shkrimtarëve, 1993, f. 251; Shih gjithashtu: Noel Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, Prishtinë: “KOHA”, 1998, f. 320-321.

<sup>26</sup> Për më shumë shih: Ana Lalaj, “Shqipëria dhe projektet e (Kon)federatave ballkanike (1941-1945)”, në: *Studime historike*, Tiranë: 2009, Nr. 3-4.

<sup>27</sup> Vladimir Dedijer, *Novi Prilozi za biografiju Josipa Broza Tita*, 2, Zagreb: “Liburnija, Rijeku, Mladost”, 1982, f. 903.

Pikërisht në këtë kohë mbahet Konferenca e Bujanit, e cila deklaroi hapur aspiratën e shqiptarëve dhe realizimin e saj mbështetur në parimin e vetëvendosjes. Në mënyrë të paparashikuar Bujani u vetëvendos përballë Jajcës. Korniza e Jugosllavisë po rrezikohej. Por Tito vazhdoi i vendosur lojën e tij të dyfishtë në Kosovë dhe në Shqipëri, madje duke i vënë ato kundër njëra tjetrës. Nuk është e rastit që nga shtabi i Titos, në të njëjtën kohë, dërgohen dy letra: njëra në Shqipëri, më 26 mars dhe tjetra në Kosovë, më 28 mars 1944. Letra e parë i dërgohet Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH nga Peko Dapçeviç (Peko Dapčević), komandant dhe Mitar Bakiç (Mitar Bakić), komisar i Korpusit II<sup>28</sup> të Ushtrisë jugosllave. Që në fillim letra bën me dije se kufijtë e Jugosllavisë nuk do të ndryshojnë pas luftës: “Ju e dini se ne mbetemi në qëndrimin se asnjë pëllambë e tokës sonë, për lirinë e së cilës luftojmë qysh tre vjet dhe japim bijtë më të mirë të vendit tonë nuk do t’ia lamë kurkujt, e aq më shumë atyne që kanë mujtë me grabitë krahinat tona në mbështetje të grupeve të okupatorit”. Më pas, duke vënë theksin te “reaksioni shqiptar në Veri të Shqipërisë”, ku njësive të Korpusit të Dytë UNÇJ i duhet “gjysëm viti të mbajnë front kundrejt kufirit të ri [të Shqipërisë]”, letërshkruesit kërkojnë që formacionet e UNÇSH të kalojnë në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë për të bashkëpunuar me forcat jugosllave. Sipas tyre “kjo do të kishte rezultate politike si në luftë kundra okupatorit ashtu edhe kundra reaksionit si sot ashtu edhe në të ardhmen”<sup>29</sup>. “Reaksioni shqiptar” në fakt ishin nacionalistët shqiptarë që kërkonin e luftonin për bashkimin e tokave shqiptare ose kundërshtarët politikë të PKJ. Dhe këtë detyrë do ta përballonin njësitet e ushtrisë shqiptare<sup>30</sup> dhe pas tyre do të vinin formacionet jugosllave. Me sa shihet

<sup>28</sup> Korpusi II i UNÇJ konsiderohej formacioni më i rëndësishëm i Ushtrisë NÇ jugosllave. Në vjeshtë të vitit 1943 ai depërtoi në trekëndëshin e Sanxhakut, Metohisë dhe Malit të Zi, me synimin që në të ardhmen të kryente operacione ushtarake në drejtim të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Kosovës.

<sup>29</sup> *AQSH*, F. 41, V. 1944, D. 136. Letër e Peko Dapçeviçit Peko (Peko Dapčević), komandant dhe Mitar Bakiçit (Mitar Bakić), komisar i Korpusit II dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH.

<sup>30</sup> Nga letra e 26 marsit 1944 merret vesh gjithashtu se Vasil Shanto, anëtar i KQ të PKSH dhe delegat i KQ PKSH për Qarkorin e Shkodrës, ka qenë në Jugosllavi. Peko Dapçeviç dhe Mitar Bakiç, në letrën e tyre shkruajnë se “Me të ndjerin Vasko [Vasil Shanto], i cili prej nesh është kthyer në atë Shtab [UNÇSH], jemi marrë vesh për të koordinuar veprimet e forcave çliruese tuajat dhe tonat në

udhëheqësit jugosllavë ndjeheshin mjaft të sigurtë për t'i përdorur shqiptarët pa u bërë ndonjë koncesion aspiratave të tyre kombëtare. Këto të fundit ishin mënjeluar nga qëndrimi ideologjik i përbashkët dhe mbështetja jugosllave për udhëheqjen komuniste shqiptare për të marrë pushtetin. Në tetor 1943, Tito do të udhëzonte Hoxhën se duhej krijuar sa më shpejt qeveria komuniste dhe se shqiptarët e kishin më të lehtë të ndërmerrenin këtë hap pasi Shqipëria nuk kishte një qeveri të sajën në mërgim të njohur nga ndërkombëtarët<sup>31</sup>. Këto udhëzime të Titos, Enver Hoxha i vuri në jetë në maj 1944, në Kongresin e Këshillit Antifashist NÇ mbajtur në Përmet, ku u krijua një këshill antifashist me kompetenca ligjvënëse dhe një komitet me atributet e një qeverie të përkohshme.

Kurse letra e dytë i dërgohet Komitetit Krahinor të Kosovës dhe Metohisë nga KQ i PKJ, ku anulohen prerogativat shtetërore të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit dhe goditet aspirata kombëtare e popullsisë shqiptare të Kosovës e shprehur në Rezolutën e Konferencës së Bujanit. Megjithëse në janar 1944, Rezoluta, Thirrja dhe materialet e tjera të Konferencës së Bujanit ishin shpërndarë

---

luftën kundër armikut të përbashkët - okupatorit gjerman dhe shërbëtorëve të tij". Vasil Shanto hynte dhe dilte shpesh në Jugosllavi dhe te shumë komunistë shqiptarë ekzistonte mendimi se ai është ndërlidhës midis PKSH me PKJ (AQSH, F. 14/AP-PKSH, V. 1942, D. 5).

Në librin *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar (1939-1944)*, 3, Tiranë: "8 Nëntori", 1988, shkruhet se "Vasil Shantoja po kthehej në Shqipëri nga Jajca e Bosnjës, ku kishte shkuar si përfaqësues i Partisë Komuniste dhe i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të Shqipërisë për të marrë pjesë në Konferencën e Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë" (*Po aty*, f 641-642). Autorja e këtij shkrimi ka në dorë një dokument, ku Tito urdhëron Shtabin e Korpusit të Dytë, më 28 janar 1944, që "Shoku shqiptar [Vasil Shanto] duhet të kthehet në vendin e tij. Tani për tani nuk kemi mundësinë të tjera, vetëm që ju t'i jepni një prej shifrave rezervë, të cilat jua kemi dërgue me anë të delegacionit. Na lajmëroni kur afërsisht, ai mund të arrijë në Shqipëri dhe të fillojë lidhjen me radio me ne. Ju jepini atij të gjitha vendimet e Mbledhjes së Dytë të Plenumit të Këshillit të Përgjithshëm NÇ të Jugosllavisë [AVNOJ-t] dhe materialin tjetër që kemi. (*Novi prilozi za biografiju Josipa Broza Tita*, 2. Liburnija, Rijeku; Mladost, Zagreb, 1981, f 1056. 20 janar 1944; AQSH, F. 41, V. 1944, D. 136). Megjithatë ky dokument është i pamjaftueshëm për të pohuar nëse Vasil Shanto ishte apo nuk ishte në Jajcë.

<sup>31</sup> S. Gjakoviç, *Sukobi u Kosovu...*, f. 396. Letra e J.B.Titos dërguar Miladin Popoviçit më 9 tetor 1943.

në popullin e Kosovës, më 18 qershor Komiteti Krahinor u bën të njohur komiteteve vartëse të rretheve kritikën e KQ të PKJ ndaj vendimeve të Bujanit, duke përsëritur fjalë për fjalë letrën e Gjilasit për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj çështjes kombëtare në Kosovë<sup>32</sup>.

Edhe për udhëheqjen e PKS, në fillim të pranverës 1944, u bë e qartë se vetëvendosja e popullit të Kosovës ishte një problem i mbyllur. Që më 28 janar 1944, Tito kishte dërguar këtë mesazh për Hoxhën: “Qëndrimi i Partisë Komuniste të Bullgarisë për çështjen e Maqedonisë është krejt i padrejtë dhe shokëve të Shqipërisë duhet t’i bëhet e ditur që prej influencës së ndonjërit të mos bien në gabime të njëjta”<sup>33</sup>. Kjo letër e arritur me vonesë në Shtabin e Hoxhës mban datën e përkthimit më 23 mars 1944. Ndërsa një ditë më vonë, më 24 mars, Enver Hoxha i dërgon një letër Fadil Hoxhës, ku e uronte për krijimin e Këshillit NÇ të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit: “Formimi i Këshillit NÇ. për Kosovë e Dukagjin është një hap i madh drejt vëllazërimit të popujve të Kosovës dhe zmadhimit të Luftës Nacionalçlirimtare”<sup>34</sup>. Asnjë fjalë për vetëvendosjen dhe aspiratën e popullit të Kosovës! Dhe nuk mund të bëhej ndryshe kur pesë muaj më parë ishte hedhur poshtë Konferenca e Mukjes ku ishte marrë vendimi për krijimin e Shqipërisë etnike. Pra, Tito kishte arritur që në Kosovë të heshte për Bujanin, kurse në Shqipëri të heshte për Kosovën. Urdhri i Titos në letrën e 6 dhjetorit 1943 se “Nuk ka nevojë me proklamue që midis nesh dhe Shqipërisë demokratike antimperialiste kjo çështje [Kosova] mund të jetë problem”<sup>35</sup>, ishte plotësuar.

<sup>32</sup> *Zbornik...*, Tom 1, Knjiga 19, dok. 143, f. 557.

<sup>33</sup> *AQSH*, F. 41, V. 1944, D. 136.

<sup>34</sup> *Po aty*, D. 52. Letër e Enver Hoxhës dërguar Fadil Hoxhës, më 24 mars 1944, me rastin e krijimit të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e Rrafshit të Dukagjionit. Ndërsa heshte për vetëvendosjen e popullsisë shqiptare në Kosovë, Enver Hoxha këshillonte: “Flamurin e kësaj lufte çlirimtare që e udhëheq me kaq brio [trimeri] dhe sukses, shoku i madh Tito, ta ngrini lart e më lart se nga ajo luftë varet fati i gjithë popujve të Jugosllavisë. Të shumëzoni përpjekjet e juaja dhe këto t’i çoni drejt fitores, me atë sigurinë e veçantë që karakterizon udhëheqësit e Luftës Nacional Çlirimtare të popujve të Jugosllavisë”.

<sup>35</sup> *Po aty*, F. 14/AP-PKS, V. 1943-1944, D. 39. Letra e J.B.Titos dërguar KQ të PKS më 6 dhjetor 1943.

### **Vlerat e Bujanit nuk mund të zhbëhen**

Heshtja ndaj Konferencës së Bujanit ishte sinjali i parë i tronditjeve që do të përjetonte Kosova pas Luftës. Konferenca e Bujanit dhe statusi i Kosovës do të kishin një lidhje organike me njëri tjetrin: Sa herë evoluonte statusi i Kosovës, Konferenca e Bujanit do të merrej si referenca kryesore e mëvetësisë së saj, e sa herë minimizohej statusi i Kosovës, do të goditej dhe Konferenca e Bujanit.

Konferencën e Bujanit filluan ta sulmojnë pa u tharë akoma boja në vendimet e saj. Të parët ishin drejtuesit komunistë jugosllavë. Po përgatitej furtuna e vitit 1945, vendosja e Administratës ushtarake dhe varësia e të gjitha organeve drejtuese të Kosovës nga Serbia, deri te aneksimi i vetë Kosovës.

Pas Luftës, dritë-hijet mbi Konferencën e Bujanit do të alternoheshin. Pas Plenumit të Brionit, korrik 1966, kur Kosova ashtu si gjithë Jugosllavia u përfshi në procesin e ndryshimeve kushtetuese, intelektualët e Kosovës në diskutimet e tyre publike kërkuan statusin e kombit për popullsinë shqiptare në Jugosllavi dhe statusin e Republikës për Kosovën. Një nga argumentet e tyre kryesore që të arriheshin këta objektivë ishte Konferenca e Bujanit me vendimet e saj që sanksionuan mëvetësinë e krahinës së Kosovës<sup>36</sup>.

Por, pas ngjarjeve të vitit 1981, kur shumë drejtues shqiptarë të Kosovës, që vinin nga Lufta, u detyruan të largoheshin nga pushteti, Konferenca e Bujanit u bë “delja e zezë” e historisë së Luftës. Kur autonomia e Kosovës u tkurr dhe u minimizua derisa arriti në likuidimin e saj nëpërmjet një dhune të egër antikushtetuese, vendimet e Konferencës së Bujanit konsideroheshin si rrezik që gjeneronte ndjenjat kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi. Udhëheqja federative komuniste, në vitin 1987 mori vendim për të hequr nga dokumenti i Rezolutës së Bujanit pasazhin për aspiratat kombëtare të popullit shqiptar dhe vetëvendosjen. Një falsifikim absurd i politikëbërësve jugosllavë që mendonin se duke fshirë gjurmët e historisë së Kosovës mund ta linin atë pa histori. Megjithatë Konferenca e Bujanit mbijetoi, pasi ishte shprehje e një vullneti të lirë e të sinqertë të kosovarëve për të ardhmen e tyre nacionale.

---

<sup>36</sup> Hajredin Hoxha, “Procesi i vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar gjatë revolucionit dhe ndërtimit socialist”, në: *Kosova-Kosovo*, Prishtinë: 1973, Nr. 2, f. 57-80.

Pas vitit 1981, siç ndodh jo rrallë në sistemet diktatoriale, edhe historianët jugosllavë filluan të silleshin si politikanë. Ata i kthyen vlerat e Bujanit - në antivlera, meritat - në faje dhe arritjet - në mashtrime të qëllimshme. Branko Petranović (Branko Petranović), historiani jugosllav, shprehet se “një e pesta e delegatëve që votuan në Bujan nuk ishin qytetarë të Jugosllavisë” e se “Konferenca u përgatit nga komunistët, të cilët kishin emigruar në Shqipëri përpara vitit 1941 e që mbanin lidhje organizative me PKS”<sup>37</sup>. Në pamje të parë duket se prania e 10 pjesëmarrësve nga Shqipëria u jep armë atyre që marrin përsipër të rrezojnë me çdo kusht Bujanin. Është tepër tendencioze që ky fakt të ngrihet në shkallë argumenti për ta cilësuar Konferencën si “shqiptaromadhe”, apo “të paligjshme”<sup>38</sup>. Vetë kushtet kur mbahej Konferenca, mjediset ku përgatitej ajo, e shpjegojnë qartë e s’lenë shteg për ekuivoke. Këta delegatë nuk ishin përfaqësues të dërguar të PKS. Më 22 nëntor 1943, Pavle Joviçević-Rade, në emër të Komitetit Krahinor të Kosovës i kërkoi KQ PKS që “Brenda datës 30 të këtij muaji ju lutemi të dërgoni një ose dy delegatë të K.N.Ç. të Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në konferencën e përgjithshme të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit (Metohijes) për me formue Këshillin e Përgjithshëm të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit. Këtu ka mbririt Mehmet Hoxha, por ky nuk mund të quhet delegat i thirrur pse ka për të qëndrue përgjithmon këtu”<sup>39</sup>. Por gjatë Operacionit Armik të Dimrit, kur Shtabi i UNÇSH mbeti i rrethuar për tre muaj (dhjetor 1943-shkurt 1944) në Martanesh e Çermenikë, problemi i delegatëve për Konferencën në Kosovë duhet të ketë dalë jashtë vëmendjes së udhëheqjes së PKS.

Ata shqiptarë nga Shqipëria e Vjetër që morën pjesë në Konferencë, ishin thjesht veprimtarë të këshillave nacionalçlirimtare të fshatrave të Malësisë së Gjakovës dhe luftëtarë aktivë të njësive partizane që vepronin në ato anë e në Rrafsh të Dukagjinit, madje dhe në Plavë. Është i njohur kontributi i tyre në organizimin e masivizimin e luftës në ato territore, ashtu siç u duk edhe në ditët e Konferencës e më pas, kur u krijua batalioni i përbashkët “Curri -Rexhepi” me shqiptarë të Kosovës

<sup>37</sup> Branko Petranović, “AVNOJ and Bujan Conference”, në: *Kosovo, Past, and Present*, Belgrade: 1989, f.138.

<sup>38</sup> *Po aty*.

<sup>39</sup> *AQSH*, F. 14/ *AP-PKSH*, V. 1943-1944, D. 39, f. 42.

dhe të Shqipërisë<sup>40</sup>, i cili mori pjesë në një varg betejash me forcat gjermane në Kosovë e në Mal të Zi. Në këto rrethana të bashkëveprimit kaq konkret dhe të frymës bashkëpunuese të vendosur prej kohësh midis dy lëvizjeve nacionalçlirimtare në Shqipëri e në Jugosllavi, as që mund të bëhej shqetësuese se paskëshin ardhur në konferencë aktivistë dhe partizanë nga Malësia e Gjakovës. Madje mund të themi se, emrat e tyre krahas shqiptarëve të tjerë që morën pjesë në Konferencën e Bujanit, e rrisnin impaktin e kësaj konference te populli shqiptar i Kosovës, gjë për të cilën udhëheqja komuniste jugosllave kishte aq shumë nevojë në atë kohë.

E sa për pohimin akuzues se, ishin komunistët shqiptarë të ardhur nga Shqipëria në vitin 1941, fajtorët që organizuan Konferencën e Bujanit<sup>41</sup>, ky është një gjest mosmirënjohës dhe denigrues. Dihet mirëfilli se, të rinjtë kosovarë që kishin ardhur me studime në Shqipëri para Luftës së Dytë Botërore, ishin përfshirë në lëvizjen komuniste duke u bërë anëtarë të grupeve komuniste shqiptare, më së shumti të grupit të Shkodrës. Pas pushtimit të Jugosllavisë nga trupat e Boshtit e pas bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, autoritetet e Tiranës i dërguan ata si mësues apo zyrtarë publikë në Kosovë, gjë që përputhej dhe me vullnetin e tyre. Duke vepruar legalisht si mësues dhe nëpunës ata lëviznin lirisht në Kosovë e Shqipëri, gjë që i mundësonte të kryenin veprimtari ilegale edhe si komunistë. Shpejt ata u bënë anëtarë të PKJ dhe luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovë, duke u bërë strumbullari i nxitjes dhe tërheqjes së shqiptarëve në luftë. Për kontributin që dhanë në Luftë, por dhe për nevojat që kishte pushteti i pasluftës për ta, ata zunë vend në strukturat drejtuese politike dhe ushtarake në Kosovë e Jugosllavi. Ndër ta mund të përmendim: Fadil Hoxha, Emin Duraku, Xhavit Nimani, Elhami Nimani, Ismet Shaqiri, Veli Deva, Xhevdet Doda, Xhevdet Hamza, Xheladin Hana, Sait Zatriç, Rexhep Xhiha, Mazllum Këpuska, Beqir Ndou, Hysni Zajmi dhe të tjerë.<sup>42</sup>

Përpjekje për të zhvleftësuar Konferencën e Bujanit, kohët e fundit janë bërë në Kosovë dhe në Shqipëri. Pjesëmarrësit e Konferencës së

---

<sup>40</sup> *Zbornik...*, Tom I, Knjiga 19, Dok. 84, f. 390-391. Më 12 janar 1944, u krijua batalioni "Curri -Rexhepi", i cili ishte nën komandën e Shtabit Ushtarak të Kosovës.

<sup>41</sup> B. Petranović, "AVNOJ and ...", f.138.

<sup>42</sup> *Zbornik...*, Tom I, Knjiga 19, Dok. 84, f. 37, 40.

Bujanit akuzohen se “nuk ishin mandatuar nga populli i Kosovës, por ishin caktuar nga Komiteti Krahinor i PKJ për Kosovë Metohinë, ata nuk ishin zgjedhur, nuk përfaqësonin zona të caktuara, por ishin të përzgjedhur”, se në të “nuk u përfaqësuan të gjitha shtresat dhe grupimet politike të Kosovës, por vetëm ithtarët e të ashtuquajturës Lëvizje Nacional Çlirimtare, gjegjësisht komuniste”<sup>43</sup> etj. Është e vërtetë që vendimi për formimin e Këshillit Krahinor NÇ të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit u mor në një forum komunist, Komiteti Krahinor i PKJ për Kosmetin, i mbajtur në Sharr më 4-6 nëntor 1943. Ky hap hynte në strategjinë e PKJ për krijimin e Frontit të Bashkuar Nacional Antifashist. Ata që u ftuan për të ardhur në konferencë ishin luftëtarë në vijën e parë të zjarrit, veprimtarë të vendosur dhe simpatizantë të linjës së Luftës Antifashiste. Konferenca nuk ishte pluraliste në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por shtresëzimi shoqëror dhe politik i pjesëmarrësve të saj ishte i shumëllojshëm: prefektë, partizanë, komunistë, mësues, punëtorë, fshatarë etj.

E përbashkëta ishte se, të gjithë kundërshtonin pushtimin nazist të Kosovës. Kjo ishte themelore. Me kohë këta njerëz do të bëheshin promotori i rezistencës në Kosovë. Pra, Këshilli NÇ i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit ishte një front antifashist. Si i tillë ai do të përfaqësonte një potencial të fuqishëm në luftë. Ja se ç’ shkruan Fadil Hoxha në kujtimet e tij: “U shkrova letra simpatizuesve ose njerëzve me influencë, të cilët i ftojsha në emër të Shtabit Kryesor të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Komitetit që të marrin pjesë në Këshillin NÇ. Letrat ia dërgova organizatës në Ferizaj, e cila pastaj do t’ua çonte njerëzve... Në ilegalitet të plotë punuem ditë e natë dhe biseduam me një numër të konsiderueshëm simpatizuesish tanë, si dhe me disa qytetarë autoritative për të cilët mendonim se do të bashkëpunonin me ne. Nuk ishte i vogël numri i njerëzve me të cilët bisedova unë e të cilët nuk e pranuan ftesën për bashkëpunim dhe për pjesëmarrje në Konferencë”<sup>44</sup>. Nëse pati nga ata që nuk morrën pjesë në mbledhje, kjo është normale në ato vite lufte dhe për kushtet e Kosovës. Megjithatë ata që u mblodhën në Bujan, në dhjetor 1943, u përcaktuan për një aspiratë e një qëndrim që

<sup>43</sup> Shefqet Hoxha, “Platforma e Bujanit ishte një utopi”, në: *Që historia shqiptare të mos mbesë në kurthin serbo-sllav*, Prishtinë: shtypshkronja Grafobeni, 2011; f. 43-50.

<sup>44</sup> *Fadil Hoxha në vetën e parë*, redaktor Veton Surroi, Prishtinë: “KOHA”, 2010, f. 160.

vështirë të gjendet një variant më i mirë për kohën. A mund të veprohej ndryshe në Kosovën e pushtuar dhe ku nuk kishte territore të lira? Akoma më tej, a ka ndonjë organizatë, lidhje, besëlidhje, qoftë edhe ato të shpallura nacionaliste, të krijuara gjatë viteve të pushtimit nazifashist në Shqipëri, ku anëtarët e tyre të kenë marrë mandatin përfaqësues me anë të zgjedhjeve të lira? Pa folur pastaj për qeveritë apo asamblatë kombëtare të krijuara në këta vite. Sigurisht, komunistët i përdorën frontet nacionalçlirimtare edhe për të kapur pushtetin, por në vitet e rezistencës antifashiste asnjë parti apo grup politik nuk mund të mbijetonte nëse nuk merrte pjesë aktive në këtë rezistencë, e aq më pak nëse bashkëpunonte me pushtuesin. Përndryshe, ata do të shuheshin së bashku me pushtuesin, ashtu siç edhe ndodhi në fakt.

Konferenca e Bujanit nuk ka nevojë as të zbukurohet dhe as duhet të hidhet poshtë. Ajo mbetet ajo që është. Të vërtetat për përgatitjen, zhvillimin e përfundimet që ajo arriti mbeten vlera të dallueshme. Ato janë në dokumentacionet përkatëse të publikuara, në kujtimet e pjesëmarrësve, në logjikën e zhvillimit të ngjarjeve të atëhershme. Nëse në punimet e saj mund të gjendet ndonjë e metë, për një vështrim realist e serioz kjo do të ishte e shpjegueshme në ato rrethana të vështira të luftës e të ilegalitetit. Konferenca e Bujanit ishte shpresë për gjithë ata shqiptarë që po ecnin në rrugën e lirisë. Të mos lejojmë që dhuna, mashtrimet dhe manipulimet që ka përjetuar populli i Kosovës në Jugosllavinë komuniste, të na e mjegullojnë arsyen për të vlerësuar drejt Konferencën e Bujanit dhe kohën kur ajo u mbajt. Le të gjykojmë mbi atë që ka ndodhur dhe jo mbi atë që duhej të ndodhte. Shqipërisë në atë kohë i mungonte legjitimiteti i shtetit. Shqipëria gjermane nuk ishte shteti legjitim i shqiptarëve, ndërsa Mbretit Zog nuk iu njoh nga Aleatët e drejta e kryetarit të shtetit në mërgim, si gjithë mbretërve të tjerë evropianë të larguar nga vendi i tyre. Shqipëria ishte në kërkim të aleatëve të mëdhenj. Ishte fati i keq i shqiptarëve që aleatët historikë i kishin përballë dhe jo në krah gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në Konferencën e Bujanit, vetëvendosja u shpreh në formën e aspiratës dhe të së drejtës natyrore për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, por nuk u realizua. Pavarësisht se ç'ndodhi më pas, shqiptarët vazhduan të besojnë te vetëvendosja dhe nuk i ndërprejnë përpjekjet për ta bërë atë realitet në një kohë tjetër.

Kur Lufta e Ftohtë kishte përfunduar dhe vendimet e Versajës po zhbëheshin në Evropë, ishte SHBA ajo që mirëkuptoi vuajtjet shumëvjeçare të shqiptarëve të Kosovës, ringjalli shpresën dhe garantoi

kushtet demokratike që edhe ata, si popujt e tjerë të çliruar nga perandoritë komuniste të vetëvendosnin. Siç dihet, më 17 shkurt 2008, shqiptarët sanksionuan pavarësinë dhe shpallën Republikën e Kosovës. E parë në dy kohë, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në Rendin e Ri Botëror të vendosur pas Luftës së Ftohtë, Konferenca e Bujanit mbetet referencë e pashmangshme në përpjekjet e popullit të Kosovës për liri dhe vetëvendosje. Në këtë kontekst natyrshëm lind nevoja për t'i ruajtur vlerat e Konferencës së Bujanit.

### *S u m m a r y*

#### THE BUJAN'S CONFERENCE, DECEMBER 31, 1943-JANUARY 2, 1944, A REASSESSMENT

Even today, just 67 years since the Bujan's Conference has been summoned, the writings for it continue to be published. The authors come from the left and the right sides, different nationalities, historians, journalists, and politicians. The article considers the Bujan's Conference from several points of view: political, military, social, national and international. Article deals with the slogan of self-determination proclaimed by Antifascist Allies, the project of "Greater Albania" applied by German Nazi in Kosova, the specific national circumstances of the Kosovar people, which affected their participation in the Antifascist movement during WWII. There are analyzed the decisions of Bujan's Conference and it is explained why they are in the contrary with the AVNOJ conference. The ethnic ratio in the Bujan's Conference was in accordance with the ethnic structure of the people of Kosova. So, the majority of the participants in Bujan's Conference were Albanians and the decisions of the conference slid out of the Yugoslav leadership hands. But Tito made use of the right of the self-determination as long as he needed. At the end of the WWII and immediately after it, the Yugoslav leadership imposed on the Kosovars inclusion in Yugoslavia against their national aspirations.